

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-090/15

**Prishtinë,
21 mars 2018**

Në çështjen juridike të:

M. S.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13479), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 21 mars 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga M. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13479) të datës 13 mars 2014, refuzohet si e pa bazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 i datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13479, vërtetohet.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 18 shtator 2006, M.S (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar që të njihet si bashkëpronar i pjesës $\frac{1}{4}$ pjesë ideale së ngastrës kadastrale nr. 2583/1 me sipërfaqe prej 00.44.28 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur “Vlaštica Przar”, Komuna e Gjilanit. Pala ankuese thekson se ngastrën kadastrale nr. 2583/1 e kishte humbur më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të cila kanë ndodhur në Kosovë më 1998/99.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij , pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së dokumentet në vijim:
 - Fletën poseduese nr. 382 të lëshuar nga kadastri i zhvendosur në Republikën e Serbisë, Zyrën e Gjeodezisë për Komunën e Gjilanit, zona kadastrale Llashticë më 29 gusht 2006, në të cilën figuron se ngastra kadastrale nr. 2583/1 është e regjistruar në emër të palës ankuese si bashkëpronar i pjesës $\frac{1}{4}$ të pronës;
 - Aktvendimin mbi trashëgiminë O.br. 55/70, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 21 dhjetor 1971, sipas të cilit, pala ankuese ka trashëguar $\frac{1}{4}$ e ngastrës kadastrale nr. 2583 nga gjyshi i tij P. S. Aktvendimi është bërë i formës së prerë që nga 24 prilli 1974.
 - Kontratën mbi ndarjen e pronës së paluajtshme Cv.br.1213/79 të lidhur më 2 nëntor 1979 në Gjilan me anë të së cilës ngastra kadastrale 2583/1 me sipërfaqe prej 00.44.28 ha, i takon palës ankuese.

3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka organizuar njoftimin e kërkesës disa herë. Pas marrjes së informatave lidhur me koordinatat e ngastrës kadastrale nr. 2583/1 nga Drejtoria e gjeodezisë, pronës dhe kadastrit e komunës së Gjilanit, ekipi njoftues ka gjetur se ngastra kadastrale nr. 2583/1 nuk ekziston, mirëpo koordinatat përputhen me ngastrën kadastrale nr. 2523/1, në vend të ngastrës kadastrale nr. 2583/1. Ekipi i njoftimit ka vendosur shenjën me të cilën tregohet se prona është objekt i kërkesës dhe që palët e interesuara duhet të paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Asnjë person i interesuar nuk është paraqitur pranë AKP-së si palë përgjegjëse në kërkesë, prandaj kërkesa është konsideruar si jokontestuese.
4. Edhe aktvendimi mbi trashëgiminë O.br. 55/70 edhe kontrata mbi ndarjen Cv.br.1213/79 janë verifikuar pozitivisht. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së sipas *detyrës zyrtare* ka gjetur certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme UL-70403008-00382 të lëshuar nga Komuna e Gjilanit më 9 korrik 2010 në të cilën figuron se ngastra kadastrale nr. 2523/1 me sipërfaqe prej 00.44.28 ha, është regjistruar në emër të palës ankuese si bashkëpronar i pjesës $\frac{1}{4}$ së barabartë.
5. Nga parashtrirat në shkresat e lëndës shihet se pala ankuese është njoftuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së se ngastra kadastrale nr. 2583/1 siç është kërkuar nga ai nuk ekziston, dhe në vend të saj është gjetur ngastra kadastrale nr. 2523/1 me sipërfaqe të njëjtë siç është kërkuar nga ai, dhe pala ankuese është pajtuar që kërkesa të procedohet me ngastrën e re kadastrale, përkatësisht ngastrën kadastrale nr. 2523/1 (shih faqe nr. 067 të shkresave të lëndës).
6. Për më tepër, sipas gjetjeve në kërkesë (shih faqe nr. 067), vetë pala ankuese ka konfirmuar se ai është larguar nga Kosova në vitet 1970-ta dhe se nuk e ka rimarrë posedimin e pronës para konfliktit.
7. Më 13 mars 2014, KKKP-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/228/2014 ka hedhur poshtë kërkesën. Në vendim thuhet: “Komisioni konsideron se, në bazë të dokumenteve të ndryshme të dorëzuara nga pala ankuese dhe të verifikuara sipas *detyrës zyrtare* ose në bazë të deklaratës së vetë të pandehurit, ai ka dështuar që të tregojë se kërkesa përfshinë rrethanat që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i vitit 1998-1999, rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë mandatit të Komisionit dhe duhet të hedhet poshtë”.

8. Më 22 tetor 2014, vendimi i është dorëzuar palës ankuese. Më 20 nëntor 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë pranë Gjykatës Supreme.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese e kundërshton vendimi për shkak të shkeljes së rëndë të procedurës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
10. Ai thekson se asnjëherë nuk e ka njoftuar AKP-në gjatë procedurës se e ka humbur posedimin para luftës më 1998-99, siç është theksuar në vendimin e KKPK-së.
11. Pala ankuese insiston se ai është pronar i ngastrës kadastrale nr. 2583/1, me kulturë mal i klasës së 3-të me sipërfaqe prej 00.44.28 ha e cila është e regjistruar në fletën poseduese nr. 382.
12. Pala ankuese kërkon anulimin e vendimit të KKPK-së dhe kthimin e lëndës në rishqyrtim të AKP-ja ose vendim për ri-posedim.

Arsyetimi ligjor:

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është përcaktuar me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Megjithatë, ankesa nuk është e bazuar.
14. Gjykata Supreme nuk ka gjetur as vërtetim të gabuar të fakteve e as zbatim të gabuar të ligjit procedural apo material. KKPK-ja ka vlerësuar drejtë se kërkesa nuk bie brenda fushëveprimit të kompetencave të tij.
15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i ankesës ka të drejtë në një urdhër për ri posedimin e pronës nëse paraqitësi i ankesës vërteton të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, dhe se ai nuk ka qenë në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

16. Në lëndën në fjalë, gjykata ka gjetur një shënim të një zyrtari të AKP-së, i cili e ka përshkruar një bisedë me palën ankuese në lidhje me pronën e kërkuar: "ES ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës për të sqaruar pse ai gjatë marrjes së kërkesës ka deklaruar se e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar gjatë vitit 99, dhe më pas ka deklaruar se posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur në vitin 1970. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se është larguar nga Kosova në vitin 1970 dhe ka shkuar në Beograd ku ai ende jeton. Ai nuk ka dhënë ndonjë shpjegim pse ka një mospërputhje të tillë midis deklaratave të tij."
17. Për më tepër, në shkallë të parë, pala ankuese është pajtuar që kërkesa e tij të procesohet me ngastrën kadastrale të re nr. 2523/1, kurse gjatë fazës së apelit ai insiston se kjo kërkesë duhet të procedohet me ngastrën kadastrale nr. 2583/1.
18. Më 29 Dhjetor 2017, Gjykata Supreme i ka dërguar një urdhër palës ankuese për ta sqaruar çështjen e humbjes së posedimit dhe ngastrën kadastrale të cilën ai e kërkon. Në urdhrin e gjykatës, thuhet:
- *Të sqarohet nëse është duke e kërkuar ngastrën kadastrale nr. 2583/1, mal i klasës së 3-të me sipërfaqe prej 00.44.28 ha e regjistruar në fletën poseduese 382 apo ngastrën kadastrale nr. 2523/1, mal i klasës së 3-të me sipërfaqe prej 00.44.28 ha.*
 - *Të sqarohet saktësisht kur dhe për çfarë arsye ai ose familja e tij ka humbur posedimin e pronës së pretenduar dhe të paraqes prova që tregojnë se humbja e pronës rezulton nga kushtet e konfliktit.*
19. Pala Ankuese u përgjigj në Urdhrin e Gjykatës më 28 shkurt 2018, pothuajse 3 (tre) muaj pas skadimit të afatit të paraparë në urdhrin e gjykatës. Ai deklaroi se kishte pranuar Urdhrin e Gjykatës më 23 shkurt 2018, megjithatë, nuk paraqiti asnjë provë që do të dëshmonte se ka pranuar Urdhrin e Gjykatës me datën 23 Shkurt 2018, prandaj përgjigja e tij në Urdhr nuk do të shqyrtohej nga Gjykata.
20. Për më tepër, gjykata vëren se më 10 janar 2012, pala ankuese ka paraqitur ankesë (**GSK-KPA-A-034/12**) pranë Gjykatës Supreme për lëndën e regjistruar në AKP me numrat KPA13473, KPA13474, KPA13475, KPA13476, KPA13477 të cilat janë hedhur poshtë nga KKPK-ja me anë të vendimit KPCC/D/A/120/2011 për shkak se humbja e posedimit të pronës së kërkuar nuk lidhet me konfliktin e vitit 1998-99.

21. Objekt i kërkesave kanë qenë pronat e përfshira në dokumentet e njëjta (listën nr. 382, aktvendimin mbi trashëgiminë O.br. 55/70 dhe kontratën mbi ndarjen nr. 1213/79) siç janë prezantuar në lëndën në fjalë.
22. Sidoqoftë, për shkak se prona e kërkuar është e ndryshme, edhe pse çështja është e njëjtë, lënda në fjalë nuk bie nën parimin *res judicata*.
23. Nga shqyrtimi i mësipërm i fakteve dhe dokumenteve, si dhe për shkak se pala ankuese ka qëndruar pasiv edhe pse gjykata përmes urdhrit të saj i ka ofruar atij një mundësi për të paraqitur argumentet e tij lidhur me lëndën, gjykata konstaton se pala ankuese nuk e ka vërtetuar se humbja e pronës ka të bëjë me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999.
24. Prandaj, gjykata gjen se lënda nuk bie brenda fushëveprimit të kompetencave të saj në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
25. Në bazë të asaj që u tha më lart, ankesa është dashur të refuzohet dhe vendimi i KKKPK-së të vërtetohet sa i përket pronës së kërkuar.
26. Vendimi i gjykatës nuk e cenon të drejtën e palës ankuese që të kërkojë konfirmimin e pronës së tij pranë autoriteteve kompetente vendore.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, referent i EULEX-it